



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:226890

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520887

C.nr.877/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarës Elvira Emini, si gjyqtare individuale, në çështjen juridike kontestimore të paditëses I. G. nga fshati T. i R. K. Lipjan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Marigona Gashi avokate me seli në Lipjan, kundër të paditurit Komuna e Lipjanit me seli në Lipjan, me objekt çështjes kompensimin e shujtave ditore, shpenzimeve të udhëtimit dhe për kualifikim-licencim, jashtë seance, me datë 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditëses I.G. nga fshati T. i R. K. Lipjan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Marigona Gashi avokate me seli në Lipjan, kundër të paditurit Komuna e Lipjanit me seli në Lipjan, me objekt çështjes kompensimin e shujtave ditore, shpenzimeve të udhëtimit dhe për kualifikim-licencim, në këtë çështje juridike kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës së saj, pranë kësaj gjykate me datën 11.10.2021, ka parashtruar kërkesë kundër të paditurës, me objekt çështjes kompensimin e shujtës ditore, shpenzimeve të udhëtimit dhe për kualifikim-licencim.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses, të njëjtën e ka kthyer në plotësim dhe rregullim tek përfaqësuesja e autorizuar e paditëses me detyrimin si në aktvendimin e datës 04.03.2024.

Për këtë arsye gjykata duke marrë parasysh faktin se e njëjta nuk i përmban konditat konform nenit 253 të LPK-së të të veprohet sipas saj, me aktvendimin e datës 04.03.2024, padinë e paditëses ia ka kthyer në plotësim dhe rregullim të autorizuarës së saj, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së. Ashtu që paditësen, respektivisht të autorizuarën e saj, e ka detyruar në drejtim të precizimit të kërkesëpadisë, duke e precizuar shumën e kërkuar me padi, periudhën për të cilën kërkohet kompensimi i shujtës ditore, kualifikimit, si dhe provat me të cilat kërkohet faktet e theksuara në padi, si vërtetimin e ditëve të pranisë në punë për periudhën e kërkuar, vendimin e Qeverisë së RKS të vitit 2008, të gjitha në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën e paditur, në afatin prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në të kundërtën padia e paditëses do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësja respektivisht e autorizuarja e saj, nuk i është përmbajtur aktvendimit të marrë nga kjo gjykatë me datën 04.03.2024, edhe përkundër faktit se nga shkresat e lëndës vërtetohet se e autorizuarja e paditëses e ka pranuar aktvendimin e gjykatës me datën 11.03.2024.

Në bazë të nenit 102.3 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet se “do te konsiderohet e tërhequr parashtrësia po qe se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit te caktuar, e në qofte se kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht e pa plotësuar do te hedhet poshtë”.

Gjykata vlerëson se të autorizuarës së paditëses i është dorëzuar aktvendimi konform nenit 112 të LPK-së, dhe meqenëse e njëjta nuk kanë vepruar brenda afatit ligjor të dhënë nga gjykata, respektivisht nuk e ka plotësuar padinë, sipas aktvendimit të lartshënuar, andaj në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata padinë e paditëses e konsideroi të tërhequr.

Gjyqtarja e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 102.3 dhe 387 pika c të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -DEGA NE LIPJAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.877/21 me datën 15.03.2024.

G J Y Q T A R J A
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:226890
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05520887